

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **328-26-4829-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi i pajisjeve të sigurisë (hyrje-dalje) për KGjK, Pallatin e Drejtësisë, Gjykatën Themelore Gjakovë dhe Gjykatën Themelore Ferizaj**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	TETRONIKS L.L.C.
NUI	810863325
Adresa	Rr.Ali Aliu Kelmendi nr.87
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	038722253
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Almir Ajeti
Adresa elektronike	info@tetroniks.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi i pajisjeve të sigurisë (hyrje-dalje) për KGjK, Pallatin e Drejtësisë, Gjykatën Themelore Gjakovë dhe Gjykatën Themelore Ferizaj

1. Furnizimi dhe montimi i pajisjeve të sigurisë (hyrje-dalje) për KGjK, Pallatin e Drejtësisë, Gjykatën Themelore Gjakovë dhe Gjykatën Themelore Ferizaj

2. B05 Njoftim për Kontratë me datë 26.06.2026

3. Letër Standarde për sqarim me datë 17.07.2026

4. Afati për dorëzimin e tenderit me datë 17.08.2026

5. Njoftim për Operatorët Ekonomik me datë 14.09.2026

6. Njoftim mbi vendimin e AK dhe Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar me datë 16.09.2026

7. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e datës 21.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë 17.09.2026 kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim të vendimit të AK, ndërsa AK ka dërguar vendimin me datë 21.09.2026 duke refuzuar kërkesën tonë si të

pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në përputhje me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, paraqesim ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim në kuadër të aktivitetit të prokurimit me titull *"Furnizimi dhe montimi i pajisjeve të sigurisë (hyrje-dalje) për KGjK, Pallatin e Drejtësisë, Gjykatën Themelore Gjakovë dhe Gjykatën Themelore Ferizaj"*, me numër të prokurimit 328-26-4829-1-1-1, të publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

SQARIM

Ne i qëndrojmë në tërësi pretendimeve tona ankimore të paraqitura përmes Kërkesës për Rishqyrtim të vendimit të AK së datës 17.09.2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull dhe numër të prokurimit të lartë cekur. Meqenëse AK me vendimin e datës 21.09.2026, i ka refuzuar pretendimet tona si të pabazuara, të njëjtat pretendime i paraqesim edhe në këtë ankesë pa ndryshuar objektin, përmbajtjen dhe bazën faktike të tyre, duke i sqaruar edhe arsyetimin e dhënë nga AK-ja. Në përputhje të nenit 64.2 të Rregullores Nr.001/2022 sipas të cilit pretendimet ankimore pranë OSHP-së duhet të jenë të njëjta me ato të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

Prova: Kërkesa për Rishqyrtim

Arsyetimi i AK-së se kompania jonë eliminohet gjoja në mospërbushje të kërkesave të Dosjes së Tenderit (DT) për kapacitetet teknike dhe profesionale, konkretisht lidhur me dëshmimin e realizimit të kontratave të natyrës së njëjtë Pajisje të Sigurisë në vlerë prej 350,000.00 Eur gjatë tre viteve të fundit jo vetëm që është i pabazuar në gjendjen faktike të lëndës por paraqet edhe trajtim diskriminues e tendencioz.

Për më tepër rrjedha kohore e këtij procesi ngre dyshime serioze mbi paanshmërinë e vlerësimit të tenderit. Afati për dorëzimin e tenderëve ka qenë më 17.08.2026, ndërsa me datë 14.09.2026, AK ka nxjerrë një njoftim për zgjatjen e afatit të vlerësimit për 20 ditë shtesë me arsyetimin e "*kompleksitetit dhe natyrës së këtij aktiviteti*". Mirëpo, vetëm 2 ditë pas këtij njoftimi, AK nxjerr vendimin për eliminimin e kompanisë sonë dhe anulimin e procedurës së tenderit duke hedhur poshtë vetveten dhe duke dëshmuar se vlerësimi nuk është trajtuar me profesionalizmin dhe seriozitetin e duhur.

Argumentet ligjore dhe fakti i përmbushjes së kriterëve

Më datë 17.09.2026 në Kërkesën për Rishqyrtim kemi paraqitur argumentet ligjore dhe faktimin e përmbushjeve të kriterëve sipas kërkesës Seksionin II (Fleta e të Dhënave të Tenderit - FTD), Neni 9.1 & 9.2 i DT-së, është kërkuar shprehimisht që "*Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar kontrata të natyrës së njëjtë Pajisje të Sigurisë, gjatë tre (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, me një vlerë totale jo më të vogël se 350,000.00 Eur, dëshmia e kërkuar dokumentare: Lista e kontratave të realizuara duhet të paraqitet në mënyrë të qartë dhe të detajuar, duke përfshirë këto të dhëna për secilën kontratë: 1.Titulli i kontratës; 2.Emri i institucionit përfutës; 3.Shuma në euro (); 4.Data e fillimit të kontratës; 5.Data e përfundimit të kontratës; Në rastet kur shërbimet janë kryer për persona fizikë, duhet të bashkëngjiten dëshmi bankare përmes të cilave vërtetohet se pagesat janë realizuar nëpërmjet sistemit bankar në Republikën e Kosovës.Gjithashtu, listës së kontratave, sipas renditjes, duhet t'i bashkëngjiten edhe referencat përkatëse për secilën kontratë*".

Në përmbushje të plotë të kësaj kërkesë, ne kemi dorëzuar "Listën e kontratave të realizuara" e cila shoqërohet me referencat valide dhe dëshmitë bankare përkatëse, duke arritur vlerën totale prej 812,552.10 Eur. Kjo dëshmon qartë se pragu apo kufiri financiar i kërkuar prej 350,000.00 Eur është jo vetëm i arritur por edhe i tejkaluar në mënyrë të ndjeshme. Anashkalimi i këtij dokumentacioni nga ana e AK përbën shkelje flagrante të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Përkufizimi dhe interpretimi i drejtë i "Pajisje të Sigurisë"

Arsyetimi i AK-së dështon në kuptimin substancial të termit "Pajisje të Sigurisë". Në aspektin teknik dhe industrial, ky nocion nënkupton tërësinë e pajisjeve apo sistemeve, teknologjive, mjeteve dhe mekanizmave fizikë ose elektronikë që përdoren për të mbrojtur pronën, njerëzit, asetet ose mjediset nga kërcënimet e ndryshme. Në këtë përkufizim përfshihen drejtpërdrejt si pjesë integrale e sistemeve të dëshmuara nga kompania jonë në listën e kontratave të realizuara edhe katër shtylla teknologjike: barrierat dhe portat e shpejta, skanerët X-ray, kamerat e vëzhgimit, radiolidhjet. Me një kërkim të thjeshtë online mund të konstatohet dhe vërtetohet se këto sisteme bëjnë pjesë në fushën e sigurisë. Kjo nënkupton se, ne, si OE kemi dëshmuar përvojën dhe ekspertizën specifike teknike në fushën e sigurisë.

Për më tepër kjo procedurë është e klasifikuar me kod 93900000-7 në FPP në platformën e Prokurimit Publik si "Shërbime të Ndryshme" (ose në terminologjinë origjinale

ndërkombëtare Miscellaneous Services) që do të thotë të paklasifikuara diku tjetër ndërsa ky kod funksionon si kategori e përgjithshme për shërbimet që nuk përshtaten ose nuk kanë një kod specifik dhe të dedikuar brenda fjalorit standard të prokurimit. Andaj, të gjitha këto sisteme të prezantuara në listën e kontratave qoftë në mënyrë individuale apo të integruara gjatë 3 viteve të fundit, përbëjnë thelbin e pajisjeve të sigurisë.

Duke i injoruar këto dëshmi, AK ka rënë në kundërshtim të hapur me parimet e përcaktuara të LPP, duke shkelur:

1. Neni 7 Barazia në Trajtim dhe Mos-diskriminimi
2. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
3. Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Përfundim

Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të zbatoj edhe nenin 64 Dëshmitë e kërkesave të LPP-së, nuk ka arritur të bëjë verifikim të saktë dhe faktik të dokumentacionit në ofertë konform këtij neni 64 në të cilin thuhet "Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji".

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe provat e paraqitura, konsiderojmë se Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 21.09.2026 është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe për këtë arsye kërkojmë nga OSHP-ja që:

1. Të aprovojë ankesën si të bazuar
2. Të anuloj Vendimin e AK-së
3. Të kthejë lëndën në rivlerësim duke detyruar AK-në të marrë parasysh dëshmitë për kontratat e implementuara dhe të bëjë vlerësim të drejtë dhe profesional të ofertës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e drejtpërdrejtë të veprimit të kundërligjshëm të AK-së, ne si OE kemi pësuar dëme materiale në përgatitjen e ofertës, dëmtim të reputacionit dhe partneritetit me prodhuesit/partner ndërkombëtar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.